

**VENDIM**  
**Nr. 1029, datë 27.11.2013**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 459, DATË 23.9.1999 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMITETIT SHTETËROR PËR KULTET”,**  
**TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e ministrit të Kulturës dhe të ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në të gjithë përmbajtjen e vendimit nr. 459, datë 23.9.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, emërtimet “Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” dhe “ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” zëvendësohen, përkatësisht, me “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” dhe “ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë”.

2. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**